



Koha e lirë

Në kantonin e Bernit ka mundësi të shumta atraktive, me e kaluar kohën e lirë. Një rëndësi të madhe kanë shoqatat e shumta. Këto ofrojnë njëkohësisht mundësin me u njoftue me njerzë të tjerë.

Shoqatat

Shumë banore dhe banorë të kantonit Bernit janë anëtarë në një shoqatë (Verein | association). Ka shumë shoqata për interesa të ndryshme. Edhe në komuna të vogla ekzistojnë shoqata për sport-, kulturë dhe të tjera. Ato ofrojnë mundësi ideale për me ra në kontakt me njerëzit e tjerë. Shumica e shoqatave janë për të gjithë personat të hapura. Informacione për shoqata, gjinden edhe në faqet e internetit të komunave.

Ofertat për fëmijë dhe të rinjë

Për të rinjët ka në kantonin e Bernit shumë oferta specifike, për ta kaluar kohën e lirë dhe me njoftë bashkëmoshatar. Në shumë komuna ka pikëtakime dhe oferta të ndryshme për ta kaluar kohën e lirë. Të rinjët janë nën përkujdesje, munden me i sjell idetët dhe me i zbatue projektet e tyre (puna e të rinjëve). Ofertat janë zakonisht falas. Shoqatat për të rinjë ofrojnë mundësin, që s`bashku me bashkëmoshatar të ndërmarrin aktivitete dhe të ushtrojnë sport në natyrë. Bartës të ofertave janë shoqatat, komunat apo kishat e vendit. Ofertat janë të hapura për të gjithë të rinjët. Komuna jep njoftime të tjera.

Shëtitjet dhe kultura

Kantoni i Bernit ofronë mundësi të shumta për shëtitje dhe ofertë të pasur kulturore. Natyra është e karakterizuar prej qyteteve të vogëla, kështjellave, dhe shtëpitë e rahatshme të bujqëve. Përveç kësaj ka edhe shumë rrugë të bukura shtegëtimi- dhe për biçikleta. Një numër i madh i muzeve, ofrojnë ekspozita me tema të ndryshme. Në tërë Zvicrën janë të njohur p.sh. qendra Paul Klee apo muzeu i artit në Bern. Organizata për turizm në Bern "Made in Bern" informon për mundësit e shëtitjeve dhe ekspozitat. Informacionet për ekspozitat kulturore aktuale i gjenë njeriu edhe në gazetatat lokale.



Puna vullnetare

Puna vullnetare është një kontribut i shoqërisë për njerëzit dhe ambientin e cila nuk paguhet. Detyra të shumta merren tradicionalisht prej vullnetarëve. Një pjesë e madhe e punës bëhet në shoqata. Kështu mundet njeriu të angazhohet në shoqatat për kulturë, sport, interesa sociale, arsimim, për mbrojtjen e kafshëve dhe ambientit, shëndetësi dhe fusha të tjera. Informacione për punën vullnetare dhe mundësit e nevojshme japin zyrat për punë vullnetare Benevol, Karitasi në Bern apo kryqi i kuq zviceran (SRK | CRS) në kantonin e Bernit. Për vullnetar për detyra në fushën e azilit dhe refugjatëve, janë partnerët rajonal të kantonit përgjegjës. Andresat janë poshtë të linkuara. Më shumë informacione ndanë edhe kontakti me kishë për pyetje për refugjatë (KKF | OCA).

Sporti / Kultura / Arsimit

Në kantonin e Bernit ka shumë organizime në sport-, kultur dhe arsimim. Informacione për këtë merr njeriu në komunën e banimit apo në organizatat për turizëm. Me Kulturlegji- letërnjoftim të karitasit, kanë njerëzit me pak para, lirim për sport-kultur- dhe veprimtari arsimore. Për këtë letërnjoftim mund të bëhet kërkesa në karitas. Karitasi informohet dhe e vërteton a ka njeriu të drejtë të ketë Kulturlegji.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-bern.ch/sq/kantoni-i-bernit/koha-e-lire